**Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare**

## 1. .Informacion i përgjithshëm

Njesia ekonomike Rubicon Sha është krijuar si Sha, ne datë 29/09/2020 me seli në adresën: Njesia Administrative nr.9, RrugaAsim Vokshi, Ndertesa 15, hyrja 25, apartamenti 7, 1016, Tiranë.

Administrator dhe njekohesisht organ drejtues i njesise ekonomike eshtë Arbër Brahaj

Njesia ekonomike Rubicon Sha eshte rregjistruar dhe kryen veprimtari ekonomike me NIPT/NUIS: **M02129014T**
Objekti i veprimtarise se njesise ekonomike i rregjistruar ne Qendren kombetare te biznesit është: Ofrimi i zgjidhjeve financiaro-teknologjike (fintech).Ne vijim te licensimit te saj nga Banka e Shqipërisë, Rubicon synon te zhvilloje aktivitetin e saj tregtar ne ushtrimin e aktiviteteve te listuar si me poshtë:

- shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave
- këmbimin valutor
- shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbime të tjera ndihmëse që lidhen me veprimtarinë e institucionit financiar të parasë elektronike, si parashikohen në Rregulloren e Licensimit.

Rubicon është krijuar si një shoqëri aksionare me ofertë private ne kuptim te ligjit "Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare".
Kapitali i shoqërisë është i ndarë në aksione te zakonshme me të drejtë vote të nënshkruara dhe shlyera nga aksionarët.
Organet kryesore te shoqërisë janë:

1. Asambleja e Aksionareve
2. Këshilli Mbikëqyrës
3. Administratori

Organet drejtuese marrin masa për arritjen e standardeve të larta etike dhe profesionale në drejtimin e subjektit.
Fasqyrat financiare jane hartuar nga Jonida Lazri ekonomiste e punesuar ne njesine ekonomike .

## 2. BAZAT E PËRGATITJES

Pasqyrat finaciare jane pergatitur ne perputhje ne Standartet Nderkombetare te Raportimit financiar (SNRF),te publikuara nga Bordi i Standarteve Nderkombetare te Kontabilitetit (BSNK), dhe rregullorja Nr.2 date 10.01.2013 "Per administrimin e rrezikut ne veprimtarine e subjekteve jo banka "te miratuar nga Banka e Shqiperise .
Pergatitja e pasqyrave financiare sipas SNRF kerkon perdorimin e disa vleresimeve kontabel te rendesishme. Kjo gjithashtu kerkon qe drejtimi te jape gjykimin e tij mbi zbatimin e politikave kontabel te tyre. Fusha te cilat kerkojne nje shkalle te larte ose komplekse te gjykimit ose per te cilat vleresime apo supozime jane te rendesishme ne hartimin e pasqyrave financiare paraqiten ne shenimet spjeguse.

**(a)Deklarata e perputhshmerise**
Pasqyrat finaciare jane pergatitur ne perputhje ne Standartet Nderkombetare te Raportimit financiar (SNRF).

NUIS M02129014T
RUBICON
Rubicon Sh.A

**(b)Baza e pergatitjes**
Pasqyrat financiare jane pergatitur ne baze te kostos historike pervec investimeve te vlefshme per shitje te cilat jane pasqyruar me vleren e drejte.
**(c)Monedha raportuese funksionale .**
Pasqyrat financiare janë prezantuar në Lekë Shqiptar ("Lek"), e cila eshte monedha funksionale raportuese.
**(d)Periudha kontabel**
01/01/2021 - 31/12/ 2021.

## 3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL
### 3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet e kryera në monedha të huaj janë regjistruar fillimisht me kurset e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në këto monedha, janë rikonvertuar me kurset e këmbimit të datës së bilancit. Fitimet dhe humbjet që rezultojnë nga këmbimi janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave. Aktivet dhe detyrimet jomonetare në monedha të huaja janë konvertuar me kurset e këmbimit të datës së transaksionit. Kapitali aksioner është konvertuar me kursin e këmbimit të datës së bilancit. Diferenca ndërmjet kostos historike dhe gjendjes duke përdorur kursin e këmbimit të datës së bilancit njihen si Diferenca nga Rivleresimi në Kapital.
Kurset e këmbimit ne daten e bilancit që janë aplikuar për monedhat e huaja kryesore janë paraqitur më poshtë:

Subjekti ka kryer transaksione ne monedhen euro dhe usd
Monedha Europiane (EUR) 120.76
Monedha USD 106.54

### 3.2 Mjetet monetare
Mjetet monetare perfshijne, Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore
Për të raportuar fluksin e parasë, paraja dhe ekuivalentët e saj janë përcaktuar si: arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore, duke përfshirë rezervën minimale të detyrueshme me Bankën e Shqipërisë ("Banka Qëndrore").
Rezerva minimale e detyrueshme me Bankën e Shqipërisë është një rezervë që duhet ta mbajnë të gjitha bankat tregtare të liçensuara në Shqipëri.

### 3.3 Aktive finaciare te mbajtura per shitje
Aktive financiaret te mbajtura per shitje perfshijne investime në letra me vlerë si bono thesari, obligacione të Qeverisë dhe obligacione të huaja.
Këto investime maten fillimisht me kosto, duke përfshirë kostot e transaksionit dhe klasifikohen si më poshtë:
- Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim
- Letra me vlerë të disponueshme për shitje
- Letra me vlerë të tregtueshme

**(i) Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim**

NUIS M 02129014 T RUBICON Rubicon Sh.A

Të gjithë instrumentet financiare fillimisht regjistrohen në kosto, e cila përbëhet nga vlera e drejtë e pagesës së dhënë duke përfshire kostot e blerjes së instrumenteve financiare.
Të gjithë fitimet apo humbjet e realizuara apo të përllogaritura janë përfshire në të ardhurat neto.
Letrat me vlerë, të cilat kanë pagesa fikse apo të përcaktueshme synohen të mbahen deri në maturim. Ato përfaqësojnë bonot e thesarit dhe bonot qeveritare të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Pas regjistrimit fillestar, letrat me vlerë të mbajtura për maturim, mbahen me kosto të amortizuar, minus provizionet për zhvlerësime në vlerë. Amortizimi vjetor i zbritjeve apo i primeve për blerjen e letrave me vlerë të mbajtura për maturim i bashkohet të ardhurave të tjera nga investimi gjatë gjithë afatit të instrumentit në mënyrë që të ardhurat e njohura në çdo periudhë të përfaqësojnë të ardhura konstante nga letrat me vlere.

**(ii) Letra me vlerë të disponueshme për shitje**
Letrat me vlerë të disponueshme për shitje përfshijnë bono thesari dhe obligacione të huaja. Pas vlerësimit fillestar, letrat me vlerë, të cilat klasifikohen si të disponueshme për shitje, rivlerësohen me vlerën e tregut. Fitimet dhe humbjet si rrjedhojë e ndryshimeve në vlerën e tregut të këtyre letrave me vlerë të disponueshme për shitje përfshihen në fitimin ose humbjen neto për periudhën në të cilën ndodhin këto ndryshime.
**(iii) Letra me vlerë të tregtueshme**
Letrat me vlerë të tregtueshme përfshijnë bono thesari. Letrat me vlerë të tregtueshme regjistrohen në ditën e blerjes dhe me çmimin e blerjes duke përfshirë kostot dhe interesin e përllogaritur. Pas njohjes fillestare, letrat me vlerë të tregtueshme rivlerësohen me vlerën e tregut. Fitimet dhe humbjet si rrjedhojë e ndryshimeve në vlerën e tregut të këtyre letrave me vlerë përfshihen në fitimin ose humbjen neto të periudhës në të cilën ndodhin këto ndryshime.
**(iv) Vlera e drejte**
Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare mbështetet mbi çmimet e kuotuara të tregut, ose çmimet e agjentëve të shitjes për instrumenta financiarë të tregtueshme në tregje aktive.Për të gjitha instrumentat e tjerë financiarë vlera e drejtë përcaktohet mbi bazën e teknikave të vlerësimit. Metodat e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e rrjedhjeve monetare të skontuara, dhe krahasimin me instrumenta të tjerë të ngjashëm për të cilët ekzistojnë me çmime tregu dhe metoda vlerësimi. Përdoren gjerësisht metodat e vlerësimit për të përcaktuar vlerën e drejtë të instrumentave financiarë të zakonshëm e të thjeshtë si opsionet dhe sëap-et e normave të interesit dhe të monedhës. Për të tilla instrumenta, të dhënat për t'u përdorur në modelet e vlerësimit janë lehtësisht të vëzhgueshme në treg.

## 3.4 Huate dhe paradhenie bankave dhe institucioneve financiare

Huate dhe paradhenie bankave dhe institucioneve financiare perfshijne vendosjet nderbankare. Vlera e tyre e drejte konsiderohet te jete perafersisht e njejte me vleren e tyre kontabel.

## 3.5 Huatë dhe paradhëniet për klientët (vazhdim)

Huate dhe paradheniet e klienteve paraqiten neto nga diferenca e vleres se tyre bruto me fondin e zhvleresimit, protofoli i klienteve te njesise ekonomike ka nje vlere te drejte te perafert me vleren e tyre kontabel.

## 3.6 Mjetet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara Prona, Pajisjet dhe aktivet e patrupëzuara

NIPT M 02129014 T
RUBICON
Rubicon Sh.A

Toka dhe ndërtesa shprehen me vlerë te rivlerësuar minus zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar, ndërsa aktivet e tjera shprehen me kosto historike minus zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar

### 3.7 Mjetet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara (vazhdim)

Zhvlerësimi dhe amortizimi janë paraqitur si pakësim i kostos së pronës, pajisjeve dhe aktiveve të patrupëzuara kundrejt periudhës së vlerësuar të përdorimit të tyre, llogaritet mbi vleren e mbetur te aktivit ne cdo fund viti me pikënisje nga muaji i vënies së tyre në përdorim, dhe duke aplikuar përqindjet e zhvlerësimit dhe amortizimit si më poshtë:

**Kategoria Normat e amortizimit**
Ndërtesa 5%
Automjete 20%
Pajisje zyre 20%
Kompjutera dhe pajisje informatike 25%
Software 25%
Shoqeria ka ne aktivet e saj nje software i cili eshte i rregjistruar ne postin e aktiveve afatgjata jo materjale, eshte njohur me koston e cila eshte produkt i punes intelektuale te aksionareve te saj.
Bazuar në një analizë të të gjithë faktorëve përkatës, nuk ka kufizime të parashikueshme të periudhës gjatë së cilës aktivi pritet të gjenerojë flukse monetare prandaj Njesia ekonomike mbeshtetur ne referencat e SNK 38, paragrafi 88, vlereson kete soft me jete te dobishme te pafundme.
Një aktiv jo-material me një jetë të dobishme të pafundme nuk amortizohet.
Në përputhje me SNK 36, njësia ekonomike kërkohet të testojë aktivin jo-material me një jetë të dobishme të pafundme për çvlerësim duke krahasuar shumën e tij të rikuperueshme me vlerën e tij kontabël (neto)
(a) çdo vit, dhe
(b) nëse ka tregues se aktivi jo-material mund të jetë çvlerësuar.

Toka dhe punimet në proçes nuk zhvlerësohen
Fitimet dhe humbjet nga shitja e ndërtesave dhe pajisjeve në përdorim paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën kur janë shitur ose nxjerrë jashtë përdorimit.

### 3.8 Detyrimet ndaj klientëve

Detyrimet ndaj klientëve shprehen në shumën e mbetur të principalit.

### 3.9 Detyrimet ndaj institucioneve financiare

Detyrimet ndaj institucioneve financiare shprehen në shumën e mbetur të principalit.

### 3.10 Te ardhurat

Njohja e te ardhurave

NUIS M02128014T RUBICON Rubicon Sh.A

Te ardhurat jane rritje te perfitimeve ekonomike gjate nje periudhe kontabel te cilat mund te shfaqen ne formen e hyrjes se mjeteve monetare, rritjes se aktiveve ose uljes se detyrimeve te cilat cojne ne rritje te kapitalit. Te ardhurat perfshijne vetem vleren e drejte te perfitimeve ekonomike te marra dhe ato qe jane per tu marre nga shitja e sherbimeve gjate aktivitetit .
Te ardhurat e njesise ekonomike paraqiten ne pasqyren e performances ne postin te ardhura sipas zerave te meposhtem:
E ardhura neto per tarifa dhe komisione e cila perfshin:

- E ardhura neto nga aktiviteti shites perfshin te ardhurat nga koha e lire dhe tregtia.
- E ardhura neto nga instrumenta te tjere financiare perfshin te ardhurat nga sherbimet Utilitare
- Te ardhurat e tjera perfshijne te ardhurat nga partneriteti.

Shoqeria nuk ka realizuar te ardhura për këtë periudhë kontabel pasi ka qënë në process të marrjes së licensës për paranë elektronike nga Banka e Shqiperise .

**3.11 Shpenzimet**

**(i) Shpenzimet operative**
Shpenzimet operative regjistrohen kur ndodhin.

**(ii) Përfitimet e punonjësve**

• *Kontributi i detyrueshëm i sigurimeve shoqërore*
Njesia ekonomike derdh vetëm kontributin e detyrueshëm të sigurimeve shoqërore që siguron përfitimin e pensionit për punonjësit kur dalin në pension. Qeveria e Shqipërisë ka përgjegjësi sigurimin e pragut minimal të pensionit në Shqipëri sipas një skeme pensioni me kontribut të përcaktuar.
• *Leja vjetore e paguar*
Shoqeria regjistron si detyrim koston e vlerësuar të pa aktualizuar në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e mbyllur.

**(iii) Provigjionet**

Nje provigjion njihet kur, si pasoje e ngjarjeve te kaluara, njesia ekonomike ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive te cilat mund te vleresohen me vertetesi dhe ka mundesi te kete dalje te flukseve te ardhshme te parase per te shlyer kete detyrim.
Provigjioni percaktohet si aktualizim i flukseve te pritshme me nje norme takse qe reflekton vleresimet aktuale te tregut te parase dhe rrezikun specifik te detyrimeve. Drejtimi e ka te qarte kete proces por nuk ka marre vendime per provigjionimin e ndonje dukurie te pritshme, pasi gjykon se nuk rriskon.

**3.1 Shpenzimet (vazhdim)**

**(iii) Qiratë**

Pagesat e qirasë për një qira të zakonshme duhet të njihen si shpenzime përgjatë afatit të qirasë sipas parimit të shpërndarjes lineare, përveç rastit kur një mënyrë tjetër shpërndarje sistematike është më e përshtatshme për kohën e përdorimit dhe mënyrën e përfitimit të përdoruesit të këtij aktivi të marrë me qira.

NUIS M 02129014 T
RUBICON
Rubicon Sh.A

Njesia ekonomike ka ushtruar aktivitetin ne ambjentin e themeluesve te kompanise e cila deri ne muajin tetor 2021,me pas e ushtron aktivitetin ne ambjentin e marre me qira sipas kontratës Nr.436 Rep,Nr.266 kol dhe paguan qira të zakonshme mujore .

**3.12 Tatimi mbi fitimin**

Tatimi mbi fitimin më 31 Mars 2022 llogaritet 15% (31 dhjetor 2021: 15%) mbi fitimin e tatueshëm në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar. Fitimi i tatueshëm llogaritet duke rregulluar fitimin para tatimit me disa të ardhura dhe shpenzime sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar.

Tatim fitimi njihet ne pasqyren e performances pervec pjeses qe lidhet me zera te njohur direkt ne kapital.

Levizja e parase ,ekujvalenteve e saj dhe gjendja ne daten e bilancit jane te detajuara si me poshte:

| Emertimi | Viti 2021 |
|---|---|
| Llogari rrjedhese (gjendja ne fillim) | 13,939,781 |
| Shtesat gjate vitit (nga aksionaret) | 64,648,710 |
| Paksimet gjate vitit nga keto ; | 78,539,120 |
| **Gjendja e llogarisë rrjedhese ne 31/12/2021** | **49,371** |
| Llogari me banken qendrore paraqet gjendjen e ,shumes se ngurtesuar per marrje license nga BSH ,kjo shume do te perdoret gjate aktivitetit . | 50,000,000 |
| **Totali llogarite me Banken Qndrore me 31.12.2021** | **50,000,000** |
| **Llogari rrjedhese ne banke ne 31.12.2021 nga keto ;** | **49,371** |
| Tirana banke ne Leke Llog AL11206110420000140321961100 | 35,235 |
| Tirana Banke ne euro Llog.AL81120611042000014032196l101 | 14,136 |
| **Total** | |

Llogari te tjera te arketueshme paraqiten ne vleren e meposhteme ;

| Emertimi | Viti 2021 |
|---|---|
| Te tjera te arketueshme (tvsh per tu marre) | 19,866 |

Aktivet e trupezuara dhe te patrupezuara me vlere fillestare dhe neto paraqiten ne tabelen e meposhteme ;

NUIS M02129014 T
RUBICON
Rubicon Sh.A

## Vlera fillestare e A.A.Materjale dhe jo Materjale

| Nr | Emertimi | Gjendje ne Fillim te Vitit | Shtesa | Pakesime | Gjendje ne Fund te Vitit |
|---|---|---|---|---|---|
| I | **Aktive afatgjata Materjale** | | | | |
| 1 | Toka | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Ndertime | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 3 | Makineri,paisje | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4 | Mjete transporti | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 5 | Kompjuterike | 0 | 249,216 | 0 | 249,216 |
| 6 | Zyre | 0 | 24,400 | 0 | 24,400 |
| 7 | Te tjera | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **Totali Aktive Afatgjata Mater** | ***0*** | ***273,616*** | ***0*** | ***273,616*** |
| II | **Aktivet Afatgjata jo Materjale** | *0* | | *0* | |
| 1 | Sofware | *0* | 57,891,600 | *0* | 57,891,600 |
| | Puna e kapitalizuar ne sherbim te software | | 2,690,460 | *0* | 2,690,460 |
| 2 | Marka | *0* | 16,000 | *0* | 16,000 |
| | **Totali (I+II)** | **0** | **60,871,676** | **0** | **60,871,676** |

## Amortizimi A.A.Materiale dhe jo Materjale

| Nr | Emertimi | Gjendje ne Fillim te Vitit | Shtesa | Pakesime | Gjendje ne Fund te Vitit |
|---|---|---|---|---|---|
| I | **Aktive afatgjata Materjale** | | | | |
| 1 | Toka | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Ndertime | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 3 | Makineri,paisje | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4 | Mjete transporti | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 5 | Kompjuterike | 0 | 16,805 | 0 | 16,805 |
| 6 | Zyre | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 7 | Te tjera | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **Totali Aktive Afatgjata Mater** | ***0*** | **16,805** | **0** | **16,805** |
| II | **Aktivet Afatgjata jo Materjale** | *0* | *0* | | |
| 1 | Sofware | *0* | 0 | | |
| | Puna e kapitalizuar ne sherbim te software | *0* | 0 | 0 | |
| 2 | Marka | *0* | 0 | | |
| | **Totali (I+II)** | ***0*** | ***16,805*** | ***0*** | ***16,805*** |

## Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale dhe jo Materjale

| Nr | Emertimi | Gjendje ne Fillim te Vitit | Shtesa | Pakesime | Gjendje ne Fund te Vitit |
|---|---|---|---|---|---|
| I | **Aktive afatgjata Materjale** | | | | |
| 1 | Toka | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2 | Ndertime | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 3 | Makineri,paisje | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4 | Mjete transporti | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 5 | Kompjuterike | 0 | 249,216 | 16,805 | 232,411 |
| 6 | Zyre | 0 | 24,400 | 0 | 24,400 |
| 7 | Te tjera | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **Totali Aktive Afatgjata Mater** | ***0*** | **273,616** | **16,805** | **256,811** |
| II | **Aktivet Afatgjata jo Materjale** | *0* | | | |
| 1 | Sofware | *0* | 57,891,600 | - | 57,891,600 |
| | Puna e kapitalizuar ne sherbim te software | | 2,690,460 | - | 2,690,460 |
| 2 | Marka | *0* | 16,000 | - | 16,000 |
| | **Totali (I+II)** | ***0*** | **60,871,676** | **16,805** | **60,854,871** |

NUIS M 02129014 T
RUBICON
Rubicon Sh.A

Njesia ekonomike ne aktivet e pa trupezuara te saj ka nje software i cili eshte i rregjistruar ne postin e aktiveve afatgjata jo materjale, eshte njohur me koston e cila eshte produkt i punes intelektuale te aksionareve te saj ,i cili sipas raportvleresimit date 13.01.2021 ka nje vlere 57,891,600 leke te cilit gjate periudhes kontabel i jane bere sherbime ne vleren 2,690,460 leke te cilat rrisin vleren fillestare te tij .

Bazuar në një analizë të të gjithë faktorëve përkatës të bere nga shoqeria nuk ka kufizime të parashikueshme të periudhës gjatë së cilës aktivi pritet të gjenerojë flukse monetare prandaj Njesia ekonomike mbeshtetur ne referencat e SNK 38, paragrafi 88, vlereson kete soft me jete te dobishme te pafundme.

Në përputhje me SNK 36, njësia ekonomike kërkohet të testojë aktivin jo-material me një jetë të dobishme të pafundme për çvlerësim duke krahasuar shumën e tij të rikuperueshme me vlerën e tij kontabël (neto)

(a) çdo vit, dhe

(b) nëse ka tregues se aktivi jo-material mund të jetë çvlerësuar.

Shpenzime te shtyra paraqisin parapagimin e bere per mall/sherbim edhe paraqiten ne tabelen e meposhteme ;

| | |
|---|---|
| Parapagim per qirane | 113,364 |
| Parapagim per vulen dixhitale | 180,573 |
| **Total** | **293,937** |

Detyrime te e njesise ekonomike paraqiten ne tabelen e meposhteme;

| Emertimi | Viti 2021 |
|---|---|
| **1.Detyrime te garantuara nga te trete nga keto;** | **6,988,203** |
| Detyrime te tjera (detyrime tregtare per fatura te marra nga jo rezidente ) | 189,377 |
| Detyrime ndaj aksionareve | 6,798,826 |
| **2.Detyrime ndaj punonjesve e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore nga keto;** | **321,872,** |
| Detyrime ndaj punonjesve për pagat e muajit dhjetor | 186,114 |
| Detyrime per sigurime shoqerore (muaji dhjetor 2021) | 135,758 |
| **3.Detyrime tatimore nga keto;** | **64,043** |
| Detyrim per tatim mbi te ardhura (muaji dhjetor 2021) | 44,814 |
| Detyrim per tatimin ne burim (muaji dhjetor 2021) | 19,229 |
| **Total detyrime** | **7,374,118** |

Paraqet detyrimin qe ka njesia ekonomike ne 31 dhjetor 2021 ndaj te treteve ,aksionareve dhe detyrime ndaj tatim taksave dhe punonjesve te cilat paraqiten me vleren e drejte .

Kapitali i njesise ekonomike paraqitet sipas zerave ne tabelen e meposhteme:

| Emertimi | Viti 2021 |
|---|---|
| Kapitali i nenshkruar dhe primi i kapitalit | 113,241,855 |

NUIS M 02129014 T
RUBICON
Rubicon Sh.A

| | |
|---|---|
| *Rezerva te tjera (ligjore)* | 0 |
| Diferenca rivleresimi | 0 |
| Fitimet /humbjet e pashperndara | (617,818) |
| Fitim /humbja ushtrimore | (8,780,109) |
| Borxhi i varur | 0 |
| Totali i kapitalit | 103,843,928 |

Kapitali neto i njesise ekonomike ka pesuar ulje si rezultat i humbjeve te vitit ushtrimor pasi njesia ekonomike nuk ka realizuar te ardhura ,ne muajin dhjetor njesia ekonomike eshte pajisur me lishense nga Banka e Shqiperise per parane elektronike qe perben aktivitetin kryesor te saj.Levizja e kapitalit neto paraqitet si me poshte;

***Pasqyra e levizjes ne kapitalin neto***

| Emertimi | Kapitali i nenshkruar | Primi i lidhur me kapitalin | Rezerva rivleresimi | *Rezerva te tjera (pershkruaj)* | *Rezerva te tjera (pershkruaj)* | Diferenca nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja | Fitimet/ (humbjet) e pashperndara | Fitim/(humbja) e periudhes | Totali | Interesa jo-kontrollues | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Pozicioni financiar ne 31 Dhjetor 2020** | **3,500,000** | | | | | | | **(617,818)** | **2,882,182** | | **2,882,182** |
| Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabile | | | | | | | | | 0 | | 0 |
| **Pozicioni financiar i rideklaruar ne fillim 01/01/2021** | **3,500,000** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **(617,818)** | **2,882,182** | **0** | **2,882,182** |
| **Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:** | | | | | | | | | 0 | | 0 |
| Fitim/(humbja) e periudhes | | | | | | | 0 | (8,780,109) | (8,780,109) | | (8,780,109) |
| Te ardhura te tjera gjitheperfshirese | | | | | | | | | 0 | | 0 |
| Tatime aktuale dhe te shtyra te njohura drejtperdrejt ne kapital | | | | | | | | | 0 | | 0 |
| **Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **(8,780,109)** | **(8,780,109)** | **0** | **(8,780,109)** |
| **Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:** | | | | | | | | | 0 | | 0 |
| Emetim i kapitalit te nenshkruar | 109,741,855 | | | | | | | | 109,741,855 | | 109,741,855 |
| Dividende te shperndare | | | | | | | | | 0 | | 0 |
| Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes *(pershkruaj)* | | | | | | | | | 0 | | 0 |
| **Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike** | **109,741,855** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **109,741,855** | **0** | **109,741,855** |
| **Pozicioni financiar ne fund (viti paraardhes)** | **113,241,855** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **(9,397,927)** | **103,843,928** | **0** | **103,843,928** |
| | | | | | | | | | 0 | | 0 |
| **Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:** | | | | | | | | | 0 | | 0 |
| Fitim/(humbja) e periudhes | | | | | | | | | 0 | | 0 |
| *Te ardhura te tjera gjitheperfshirese* | | | | | | | | | 0 | | 0 |
| Tatime aktuale dhe te shtyra te njohura drejtperdrejt ne kapital | | | | | | | | | 0 | | 0 |
| **Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| **Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:** | | | | | | | | | 0 | | 0 |
| Emetim i kapitalit te nenshkruar | | | | | | | | | 0 | | 0 |
| Dividende te shperndare | | | | | | | | | 0 | | 0 |
| Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes *(pershkruaj)* | | | | | | | | | 0 | | 0 |
| **Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** |
| **Pozicioni financiar ne fund (viti aktual)** | **113,241,855** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **(9,397,927)** | **103,843,928** | **0** | **103,843,928** |

Kapitali aksionar i njesise ekonomoke eshte kapital ne para ne vleren 55,350,255 leke i investuar nga aksionaret njesise dhe kapital ne natyre ne vleren 57,891,600 leke i cili perfaqson vleren e nje Softëare i cili eshte produkt i punes intelektuale i dy aksionareve themelues te shoqerise.
Aksionaret themelues janë Armand Brahaj dhe Julia Hoxha te cilët ne momentin e themelimit ishin mbajtës secili te 50% te aksioneve te shoqërisë. Në muajin shkurt te vitit 2021 në shoqëri u shtuan dhe 10 aksionare të tjerë. Si vijon me poshte lista emrore dhe përqindja e zotëruar nga secili në kapitalin e Rubicon.

NUIS M 02129014 T
RUBICON
Rubicon Sh.A

| Aksionari | Vlera e Kapitalit | Numuri i aksioneve | Perqindja ne kapital | Kontributi |
|---|---|---|---|---|
| Armand Brahaj | 30,695,450 | 30,695,450 | 27,11% | Para;1,750,000 Natyre ;28,945,797 |
| Julia Hoxha | 30,695,617 | 30,695,617 | 27,11% | Para;1,750,000 Natyre ;28,945,797 |
| Altin Leksani | 15,500,050 | 15,500,050 | 13.69% | Para |
| Igli Gjelishti | 7,440,050 | 7,440,050 | 6,57% | Para |
| Arian Syknej | 3,100,050 | 3,100,050 | 2,74% | Para |
| Eduard Hoxha | 3,100,061 | 3,100,061 | 2,74% | Para |
| Aljula Hasa | 4,340,050 | 4,340,050 | 3,83% | Para |
| Denis Behluli | 4,960,050 | 4,960,050 | 4,38% | Para |
| Alfons Muca | 3,100,050 | 3,100,050 | 2,74% | Para |
| Eno Kotmilo | 3,100,050 | 3,100,050 | 2,74% | Para |
| NAVY YARD CAPITAL,LLC | 3,100,061 | 3,100,061 | 3,63% | Para |
| APC INTEGRATED LLC | 4,110,316 | 4,110,316 | 3,63% | Para |

**Te ardhurat**

Te ardhurat e njesise ekonomike njihen me vleren e drejte kur ato ndodhin ,per vitin ushtrimor njesia ekonomike nuk ka realizuar te ardhura pasi ka qene ne process te marrjes se licenses nga Banka e Shqiperise .

**Shpenzimet**

Shpenzimet njihen kur ato ndodhin .Shpenzimet ne njesine ekonomike paraqiten sipas zerave ne tabelen e meposhteme :

| **Emertimi** | **Viti 2021** |
|---|---|
| Shpenzime blerje mallra/sherbime | 2,118,434 |
| Shpenzime personeli | 5,059,598 |
| Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetsore | 779,389 |
| Shpenzime amortizimi (amortizimi I aktiveve afatgjata materjale) | 16,805 |
| Shpenzime te tjera(Qira ) | 257,718 |
| Shpenzime per taksa dhe tarifa vendore | 15,500 |
| Shpenzime te tjera (vleresim ,auditim ,artim pasqyrash financiare ) | 270,000 |
| Shpenzime te tjera (IT , Operative ,diferenca kursi etj) | 262,665 |
| **Totali i shpenzimeve** | **8,780,109** |

NUIS M 02129014 T
RUBICON
Rubicon Sh.A

## Tatimi mbi fitimin

| Emertimi | Viti 2021 |
|---|---|
| Te ardhurat | 0 |
| Shpenzimet | 8,780,109 |
| Fitim/Humbja e ushtrimit | (8,780,109) |
| Tatimi mbi fitimin (15%) | 0 |

## Administrimi i rrezikut financiar

Politikat e administrimit te rrezikut ne njesine ekonomike jane krijuar per te indentifikuar dhe analizuar rreziqet qe mund te shfaqen ne njesine ekonomike, per te vendosur kufizime dhe kontrolle dhe per te monitoruar zbatimin e ketyre kontrolleve.
Nje nder rreziqet qe mund te shfaqen ne njesine ekonomike eshte edhe rreziku i likuiditetit.
Rreziku i likuiditetit eshte rreziku qe njesia ekonomike nuk do te jete ne gjendje te shlyej detyrimet e saj financiare ne kohen e duhur duke qënë se njësia ekonomoke nuk ka realizuar të ardhura për periudhën raportuese dhe shpenzimet jane vetem shpenzime te nisjes se aktivitetit

**Analiza e likujditetit nepermjete raporteve te meposhteme:**

Raporti korrent =Aktive afat shkurtet /Detyrime Afat shkurter
Raporti krrent= 50,069,237/7,374,118 leke =6.7 koeficenti 6.7 tregon qe njesia ekonomike per cdo 1 lek borxh ka mbulese me 6.7 leke.

Raporti i shpejte = (Aktivet afatshkurtra – inventarin)/Detyrime afatshkurtra
Raporti i shpejte 50,069,237/7,374,118 leke =6.7 eshte i njejte me raportin korente pasi njesia ekonomike eshte njesi sherbimi dhe nuk ka inventar.

Kapitali punues (qarkullues)
Kapitali qarkullues neto përdoret gjithashtu për të vlerësuar kapacitetin e rritjes së shpejtë të biznesit.
Kapitali punues(qarkullues) =Aktive Qarkulluese -Detyrime Qarkullues
Kapitali punues(qarkullues)= 50,069,237leke -7,374,118 leke =42,695,119 leke. Projeksionet e njesise ekonomike tregojne vijushmeri te biznesit.

## Treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit

Institucioni i parasë elektronike, për ushtrimin e veprimtarisë së sigurt dhe të qëndrueshme, si dhe për përmbushjen e detyrimeve të tij gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie, siguron nivele të mjaftueshme të kapitalit.

NUIS M 02129014 T
RUBICON
Rubicon Sh.A

2. Institucioni i parasë elektronike respekton në çdo kohë treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit, siç përcaktohet në raportet e mëposhtëm:

a) raporti i kapitalit ndaj tepricës mesatare të parasë elektronike në qarkullim nuk duhet të jetë më i vogël se 2% (dy për qind), në rastet e institucionit të parasë elektronike që ushtron vetëm veprimtarinë e emetimit të parasë elektronike;

b) raporti i kapitalit ndaj shpenzimeve fikse të vitit paraardhës nuk duhet të jetë më i vogël se 10% (dhjetë për qind), në rastet e institucionit të parasë elektronike që ushtron dhe veprimtarinë financiare të shërbimit të pagesave dhe të transferimit të parave.

103,843,928 leke /8,259,226 leke= 12.6 per cdo leke te shpenzuar per shpenzimet fikse ka mbulesen 12.6 leke

**Rreziku i likuiditetit**

Institucioni i parasë elektronike siguron që niveli i aktiveve likuide të jetë në çdo rast minimalisht i barabartë me vlerën e fondeve të pranuara në këmbim të emetimit të parasë elektronike.

Aktive likuide" të një institucioni që emeton para elektronike, jane:

a) llogaritë rrjedhëse dhe/ose depozitat me afat maturiteti të mbetur deri në 7 ditë dhe/ose depozitat pa afat, në një bankë ose degë të bankës së huaj;

b) bonot e thesarit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në monedhën vendase ose të huaj, të regjistruar në bilanc si të tregtueshme ose të vendosjes;

c) llogaritë rrjedhëse dhe/ose depozitat me afat maturiteti të mbetur deri në 7 ditë dhe/ose depozitat pa afat në një bankë tregtare të huaj, e cila ka klasifikim (rating) mbi A+, sipas Standard&Poors ose të barasvlershëm me të;

d) tituj të borxhit të emetuar ose të garantuar nga qeveritë qendrore, nga bankat qendrore, institucionet ndërkombëtare ose banka shumëpalëshe të zhvillimit, klasifikimi (rating) për të cilët (kundërpartitë) sipas Standard&Poors, ose të barasvlefshëm me të, është mbi A+, të regjistruar në bilanc si të tregtueshëm ose të vendosjes.

Llogaritja e rriskut te likujditetit.
Institucioni i parasë elektronike siguron që niveli i aktiveve likuide të jetë në çdo rast minimalisht i barabartë me vlerën e fondeve të pranuara në këmbim të emetimit të parasë elektronike
Njesia ekonomike mori licensen si Institucioni i parasë elektronike brenda ne dhjetor 2021
Aktivet likuide ne 31/12/2021 janë në vleren 50,049,371 leke .
Njesia ekonomike nuk ka fonde të pranuara në këmbim të emetimit të parasë elektronike për këtë periudhë kontabël.

| HARTUESI | ADMINISTRATORI |
|---|---|
| Jonida Lazri | Arber Brahaj |

NUIS L02129014 T
RUBICON
Rubicon Sh.A